



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

KA.nr.982/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit “Supercut Production” SHPK, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit elektronik i datës 19.04.2021, konform nenit 253.5 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, jashtë seancës me datë 23.08.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e “Supercut Production” SHPK, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit elektronik i datës 19.04.2021.
- II. Paditësi i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Komerciale-Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë, Paditësi “Supercut Production” SHPK, me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi me datë 24.05.2021, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit elektronik i datës 19.04.2021.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë u konstatua se nuk ka dëshmi që paditësi e ka paguar taksën gjyqësore për padi.

Gjykata me datë 25.07.2024 Paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore

për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Sipas flete kthesës është konstatuar se dorëzimi i shkresës paditësit i është bërë me raport me 30.07.2024 të zyrës postare. Paditësi nuk është përgjigjur në raport dhe deri me tani nuk ka dorëzuar ne gjykata dëshminë se është realizuar pagesa e taksës gjyqësore.

Sipas nenit 115 paragrafi 1, ku parashihet *Në qoftë se dorëzimi i shkresës personit fizik sipas dispozitave të nenit 110 dhe 113 të këtij ligji nuk është i mundshëm, komunikuesi do ta kthejë shkresën në gjykatën e cila e ka urdhëruar dërgimin. Po që se kemi të bëjmë me komunikimin nëpërmjet postës, shkresa i kthehet postës së vendbanimit të adresatit. Në derën, përkatësisht në arkën postare të adresës së vendbanimit lehet njoftimi në të cilin tregohet vendi ku ndodhet shkresa, afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh brenda të cilit adresati duhet ta marrë shkresën, dita në të cilën lajmërimi i është dorëzuar personit që e ka pranuar dhe nënshkrimi i dorëzuesit. Në shkresën e kthyer tregohet emri i komunikuesit, shkaku për veprimin në këtë mënyrë dhe dita në të cilën lajmërimi i është lënë marrësit; dhe Nenit 115 paragrafi 2, Po që se adresati nuk e merr shkresën brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh supozohet se është kryer komunikimi në ditën kur në derën, përkatësisht në arkën postare është lënë njoftimit.*

Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia me propozim për anulim të vendimit pasi nuk ka paguar taksës gjyqësore dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.982/22, me datë 23.08.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.